



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal

Nr 13, datë 30.10.2023

I mbledhjes së këshillit të bashkisë, e cila zhvillohet në sallën e mbledhjeve në Pallatin e Kulturës “Labëria”(Ora 10¹⁰)

Marrin pjesë :

- | | |
|----------------------|---------------------|
| 1.Vullnet Bilbilaj | 20.Novrus Rrokaj |
| 2.Rajmonda Zoto | 21.Roland Strakosha |
| 3.Liljana Breshani | 22.Eglantina Aliaj |
| 4.Endri Hyseni | 23.Liri Dëma |
| 5.Edison Kapaj | 24.Dikens Bushaj |
| 6.Evis Allushi | 25.Besmir Brahimaj |
| 7.Gjergji Nika | 26.Erëmal Arapi |
| 8.Ervis Moçka | 27.Klodian Xhyheri |
| 9.Ardian Musta | 28.Aurora Qarri |
| 10.Grigor Dede | 29.Geron Gunbardhi |
| 11.Brikena Sika | 30.Alta Haluci |
| 12.Simbol Pazaj | 31.Briseida Çakërri |
| 13.Illir Aliaj | 32.Ledja Shollaj |
| 14.Frosina Qyrdeti | 33.Vjola Xhafaj |
| 15.Elpiniqi Mërkuri | 34.Shkëlqim Leskaj |
| 16.Englantina Imeraj | 35.Anxhela Shenaj |
| 17.Sokol Kushta | 36.Lorel Canaj |
| 18.Edlira Kapllanaj | 37.Marsela dashi |
| 19.Myzafer Elezi | 38.Arsen Belaj |

Mungojnë :

- 1.Brikena Puka
- 2.Elca Bezhani

- 3.Gëzim Çapoj
- 4.Jerina Dervishaj
- 5.Bujar Osmanaj
- 6.Simo Petromilo
- 7.Mujo Shakaj
- 8.Eda Begaj
- 9.Enedia Vera
- 10.Refie Laze
- 11.Anisa Ceno
- 12.Arjan Isufi
- 13.Atird Hoxha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 13/1, datë 30.10.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Të nderuar këshilltarë, meqenëse kuorumi është plotësuar , fillojmë mbledhjen.

Në fund të mbledhjes, njoftoj gratë dhe vajzat të qëndrojnë , për zgjedhjen e aleancës së grave këshilltare.

Fillojmë me pikën 1 të rendit të ditës, me “Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së këshillit të bashkisë, datë 28.09.2023 “.

E kalojmë në votim.

Pro – 30 vota

Kundër – vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 13/2, datë 30.10.2023

Znj.Liljana Breshani – Doja të apeloja për dhunën që i’u ushtrua një vajze në qytetin tonë, si nënë, grua, motër. Kujtoj këtu edhe thënien e Nënë Terezës...Doja të apeloja, drejtuar burrave dhe grave që të edukojnë fëmijë të mirë, stop dhunës ndaj grave dhe vajzave .

Z.Klodian Xhyheri – Zonja Liljana edhe unë e kisha në plan të parë, ku t’ia lëmë organeve të drejtësisë të bëjnë punën e tyre. S’kanë çna duhen koktejllet...Ne duhet të miratojmë një rezolutë, ku ne të dënojmë aktin e dhunës ushtruar ndaj grave, në emër të grupit kjo, por edhe si prind i dy vajzave. Të miratojmë të gjithë një rezolutë, ku të dënojmë aktin e dhunës ndaj grave.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Është propozim nga zoti Xhyheri. Si do veprojmë ?

Z.Klodian Xhyheri – Do ta bëjmë si material ..

Z.Daut Zëraj – Jeni dakort në parim.

Z.Myzafer Elezi – Jemi dakort në parim, të kemi gati një draft- rezolutë , e lexojmë dhe miratojmë.

Znj.Frosina Qyrdeti – Ta kalojmë në parim.

Z.Ervis Moçka – Çështja është shumë sensitive, u pranua nga të gjithë në unanimitet , por të vijë drafti, të diskutohet më pas dhe në komisione.

Z.Klodian Xhyheri – Në Konferencën e kryetarëve, zonja nënkryetare, ngriti çështjen e rënies së zjarreve, në fushë grumbullimin e mbetjeve të futej në rendin e ditës. Më thotë që është lënë për tek pika “Të ndryshme “

Znj.Elpinqi Mërkuri – Është dhe një informacion nga drejtoria e zjarrfikëses që do na japë , nisur nga kërkesa e zotit Myzafer , herën e kaluar.

Z.Klodian Xhyheri – Është tjetër gjë. Mendoj se zjarri në vend grumbullimin e mbetjeve është shqetësim i qytetarëve.

Znj.Elpinqi Mërkuri - Është i pranishëm drejtori, përfaqësues i zjarrfikëses që do na relatojë. Vazhdojmë me shprehjen e ligjshmërisë. (Lexon shkresën e ardhur nga Prefektura e Qarkut Vlorë) , ku VKB Nr 76 ÷ 83, janë vlerësuar të gjithë të ligjshëm .

Faleminderit .

Nëse nuk keni pyetje, diskutime me rendin e ditës, e kalojmë në votim.

Pro – 34 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota.

Miratohet rendi i ditës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 13/3, datë 30.10.2023

Znj.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 2 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për dhënie të ndihmës ekonomike nga të ardhurat e bashkisë, për muajin shtator 2023”.
Relaton zonja Irena.

Znj.Irena Stasa – Drejtorja e ndihmës dhe shërbimit social , paraqet 2 projektvendime çdo muaj, nga të ardhurat e bashkisë dhe nga fondi i kushtëzuar.
Përfitojnë ndihmë ekonomike nga të ardhurat e bashkisë 31 familje, në njësi dhe rajone të Bashkisë Vlorë , me vlerën e përcaktuar të fondit.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Nëqoftëse nuk ka pyetje, diskutime ... Kalojmë në votim.
Votohet.
Pro – 34 vota
Kundër – 0 vota
Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 13/4, datë 30.10.2023

Znj. Elpiniqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 3 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar, për muajin shtator 2023”.
Zonja Irena , relaton.

Znj.Irena Stasa – Përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar 16 familje.Ndryshe nga herët e tjera , përfitojnë dhe 2 familje me probleme, që kanë dalë nga sistemi dixhital. Pra, dhe këto 2 familje i shtohen familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – E kalojmë në votim
Pro – 33 vota
Kundër – 0 vota
Abstenim – 0 vota ; 1 anëtar, s’morri pjesë në votim.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA V Lorë
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 13/5, datë 30.10.2023

Znj.Elpiniaq Mërkuri – Kalojmë në pikën 4 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për emërtim rruge në territorin e Bashkisë Vlorë, me emrin “Elham Sulejman Elezaj”.

Z.Gjergji Nika – Në projektvendim, relacioni është i detajuar, është “Dëshmor i Atdheut”. Ka mbiemrin e nënkryetarit, por s’kanë asnjë lidhje. Projektvendim i tillë kaloi dhe herën e kaluar.

Z.Illir Aliaj – Jam dakort me personin në fjalë, por vetëm relacioni të ishte firmosur dhe nga anëtarët e tjerë.

Z.Myzafer Elezi – Është konsultuar dhe me ne të grupit, jemi dakort.

Znj.Alta Haluci – Edhe herën e kaluar, nuk bëhet fjalë për emrin, por në Nenin 48, të Rregullores, ku thuhet që,komisioni i përbërë nga 3 anëtarë të këshillit bashkiak dhe 2 nga shoqëria civile, pra të diskutohet nga komisioni. Pra, nuk është kaq e thjeshtë që të kalojmë çdo mbledhje emërtime, pavarësisht kontributeve që kanë. Pra, pa qenë komisioni...Nuk e kam për emrin, por se si duhet të funksionojë.

Z.Ervis Moçka – Zonja Haluci, ka shumë të drejtë. Duhet të funksionojë ky komision dhe ne kemi marrë vendime pa u ngritur ky komision. Pra, si detyrë, sekretarit të këshillit, ta ndjekë hartimin e këtij projektvendimi.

Pra, është i rënë në detyrë, “Dëshmor i Atdheut”...diskutohet në komision dhe më pas tek ne për shqyrtim.

Z.Myzafer Elezi – Kam lexuar shumë për të, është 29 vjeç, i rënë në detyrë, “Dësh,or i Atdheut”..Ne respektojmë të rënë dhe familjet e tyre.

Z.Klodian Xhyheri – Flasim për procedurën, nuk e vëmë në diskutim.Themi për procedurën, duhet ndjekur. Jam dakort me zotin Moçka, të ngrihet ky komision.

Z.Novrus Rrokaj – E ka marrë titullin, nuk është për të diskutuar.

Znj.Elpiniaq Mërkuri – Pra, propozoni që deri sa të vijë, të ngrihet komisioni, mos të na vijnë më propozime të tilla.

Atëherë kalojmë në votim.

Pro – 36 vota
Kundër – 0 vota
Abstenim – 0 vota
Miratohet .



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 13/6, datë 30.10.2023

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 5 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e sistemit të pikëzimit që do të zbatohet për klasifikimin e familjeve dhe individëve, që kanë aplikuar për të përfitur strehim në apartamentet e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave në lagjen “Kushtrimi “ Vlorë, sipas programit të Banesave me Kosto të Ulët(BKU).

Znj.Drita Mustafai/Specialiste DIIP - Një informacion në lidhje me projektvendimin.

Bashkëngjitur relacioni. Proçedura e ndjekur. EKB(Enti Kombëtar i Banesave) dhe Bashkia Vlorë, në vitin 2018, kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi për banesat me kosto të ulët. Janë 75 apartamente, sipas programit për strehim në banesat me kosto të ulët.

→ 75 persona, lista e parë dhe lista e dytë shtesë me 40 persona.

Përfitojnë ato familje që nuk kanë banesa në pronësi dhe nuk kanë kryer transaksion në hipotekë. Janë bërë njoftimet, ku thuhet kushtet, afatet, sistemi i pikëzimit, ku sistemi i pikëzimit ka qenë i afishuar , por nuk ka kaluar në këshill për miratim.Nga sistemi i pikëzimit...,plotësohet dhe niveli i të ardhurave

Kryetari i bashkisë ka ngritur një grup pune me urdhër të brendshëm,për hartimin e sistemit të pikëzimit ku bazuar në kushtet e strehimit, familjare, ekonomike dhe sociale , përbëjnë 100 pikë, në total, në sistemin e pikëzimit. Nëqoftëse, ka sygjerime dhe propozime, bëjmë ndryshimet dhe më vonë votohet dhe miratohet .

Z.Illir Aliaj – Edhe ky projektvendim kaloi në mbledhjen e komisionit të shërbimeve. I ndoqëm të gjitha sygjerimet dhe arritëm në konkluzion që të bënim disa ndryshime në sistemin e pikëzimit dhe konkretisht në :

1/3 “D” – nga 2 pikë në 3.

1/3”GJ” – nga 3 në 2 pikë.

“I” – në 2 pikë.

“K” – nga 2 në 3 pikë.

‘L” – të bëhet 1 pikë.

U la si detyrë duke qenë se, kriteret nuk ndryshojnë, sepse janë me ligj, ju la detyrë administratës që në njoftimet që do të bëjë;

-2 pika të dokumentacionit duhet të marrin rifreskim, pra, që ska transaksione, shitje- blerje me hipotekën, dhe pjesa e përmbushjes së të ardhurave.

U votuan këto dy ndryshime në komision. Mendoj që, me këto ndryshime ta kalojmë në miratim. Z.Erëmal Arapi – Në lidhje me pikën 1/1 “E, është me 8 pikë, shumë pikë dhe,1/3 “C” është me 3 pikë.

Dëgjova punonjësen, por në asnjë rajon nuk ka njoftime. Sot që falsim , nuk ka asnjë lloj publikimi. Në çdo rajon, janë vetëm listat e zgjedhësve ,qytetarët janë të keq informuar . Duhet bërë njoftimet për qytetarët.

Znj.Drita Mustafai – Në lidhje me njoftimet, i pari është bërë në vitin 2021.Aplikimet, janë shtyrë dhe 2 herë të tjera .Pra, njoftimet janë bërë 3 herë në bashki, televizione, rajone e njësi . Që prej muajit janar të këtij viti, nuk ka pas aplikime.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri - Zonja Drita , dokumentacioni a është i vlefshëm apo do të dilni me një njoftim të ri ...

Znj.Drita Mustafai – Do bëhet njoftim zyrtar , për rifreskimin e dokumentacionit. Pasi të miratohet sistemi i pikëzimit dhe të vijë nga prefekti, shprehja e ligjshmërisë, do të njoftohen këta që kanë aplikuar., jo aplikime të reja.

Z.Erëmal Arapi – Ma sqaro.I keni bërë aplikimet, afishimet, ndërkohë që nuk janë të afishuara...

Znj.Rajmonda Zoto – Janë mbyllur aplikimet sepse nuk ka, apo ?

Z.Gjergji Nika – Kemi 2 objekte me 9 kate. Struktura vetëm për apartament, garazhet janë të EKB , nuk shpërndahen ?

Për sistemin e pikëzimit, janë ndarë në 4 grupe. Shpërndarja e pikëzimit ka disa të meta.

-Pra, tek komuniteti rom dhe egjiptian , të vihet në 1 të vetëm.

-Tek 1/”L” – LGBDI , nga 2 në 1 pikë, dhe pak është 1 pikë, për viktimat të trafikimit.

Jam dakort me zotin Erëmal, në lidhje me pikën për banesat e palegalizuara..(lexon) dhe për familjet e reja me 10 pikë, shumë i lartë ...Pavarësisht nga këto..doja të dija përse janë rrëzuar listat emërore të banesave sociale, në këshill?

Z.Daut Zëraj – Nuk kanë hyrë

Z.Gjergji Nika – Lista të shikohet mirë. Të shtohet dhe 1 pikë, që je pa strehe, por e ke babain milioner..

Z.Illir Aliaj – Jemi tek sistemi i pikëzimit, më vonë lista.

Z.Gjergji Nika – Tek pjesa, viktimat të trafikimit, të rritet kjo pikë.., të grupohen banesat e palegalizuara ..

Z.Ervis Moçka – Luteshim të vinin listat në këshillin e parë. U ngrit një komision për të mbikqyrur dokumentacionin, pra, këshilli e ka bërë punën, ishin emra të përfolur. Por, sot ky sistem pikëzimi, pra, në bazë të këtij diferencimi , sistemi i pikëzimit do të ketë një listë më të mirë . Është ngritur një grup pune që ka përgatitur këtë sistem pikëzimi. Po të vazhdohet të

diskutohet pafund , nuk do të dalim në përfundim.Ta hedhim në votim dhe me propozimet e komisionit të shërbimeve.

Z.Novrus Rrokaj – Zoti Erëmal, e diskutoi. Ata janë banorë të përfshirë në projektin e rrugës Transballkanike, prandaj ishte me 8 pikë. E diskutuam dhe zoti Erëmal ra dakort, që të mos paguajë bashkia . Them që ta kalojmë në votim.

Z.Erëmal Arapi – Ne e diskutuam , ju ratë dakort. Në mendjen tuaj, keni shtëpitë e legalizuara dhe jo për ish-pronarët.

Z.Illir Aliaj – Janë qytetarë të Vlorës.

Z.Geron Gunbardhi – Zoti Erëmal, ka të drejtë .

Do parë, bërë prezent lista e mëparshme, ku kishte dhe nga administrata.

Znj.Liljana Breshani - Ne nuk e kemi miratuar këtë listë. Njerëzit që kanë nevojë le të marrin, le ti shpërndajmë.

Z.Geron Gunbardhi – Të biem dakort. I jep atij që është në proces legalizimi dhe atij të ish-pronarit, nuk i jep. Të marrë ai që e meriton..Asnjë nga bashkia apo nga komisioni...

Znj.Edlira Kapllanaj – S’janë banesa sociale, por me kosto të ulët. Kam qenë shumë pranë tyre, komunitetit rom. Më shumë se çë njoh unë atë komunitet , nuk e njihni ju. Pikëzimi është shumë i qartë, shumë i drejtë, pra, duhet tu jepet përparësi komunitetit të pakicave kombëtare si, dhe atyre që u janë prishur banesat për projektet. Dokumentat që duhet të përsërisin, atë të hipotekës , të të ardhurave dhe çertifikatën familjare.

Zonja Drita,çfarë dokumentash duhet të përsërisin, rifreskojnë qytetarët ? Pikëzimi është shumë në rregull.

Znj.Drita Mustafai – Pas miratimit të sistemit të pikëzimit, do të njoftohen familjet, të gjithë qytetarët do rikonfirmojmë gjithë dokumentacionin.

Znj.Alta Haluci - Është problem strehim. Familjet, plani që zë shtëpitë tek skela. Listat janë, pastaj pikëzimi. Tani kemi pikëzimin. Pse është shtyrë, pse se keni mbyllur më parë. Është bërë pikëzimi dhe tani do zgjidhen familjet ? Është e gabuar, mund të procedohet. A ka aplikime të reaja ? Po atyre që u është prishur shtëpia , a do marrin ? Të marrin ata që u takojnë . Unë nuk jam dakort, çfarë u tha për pikëzimin.

Z.Ervis Moçka – Po bëhet një lloja kakofonie. Nuk mund të kalojë mbas prezantimit, bëhen pyetje, debate, flasin kryetarët e grupeve..., po kalojmë nga debati në pyetje ..

Z.Azem Haliti – Në vitin 2017, parlamenti miratoi 9 pakica kombëtare. Duke zbatuar Konventën Kombëtare, këto dy komunitete, rom dhe egjiptian, të vlerësohen si pakica kombëtare, tu jepen 5%.

Z.Gjergji Nika – Do sygjeroja ...

Znj.Alta Haluci – Do aplikohet nga e para apo jo

Z.Gjergji Nika – Me sistemin e pikëzimit, është shumë e rëndësishme që administrata, pra të bëjë njoftimet, të lajmërohen në kohë ata që nuk përfitojnë. Pra, nga 75 + 40 , kjo periudhë mbyllet për 60 ditë.. Ne si këshill ti japim administratës kohë 60, 90 ditë, për sa duhen

lajmëruar, për sa duhet bërë. Tërheqja e dokumentacionit, do të tregojë familjet që splotësojnë pikëzimin do të tërhiqen, pastaj do hapen vendet.

Znj.Alta Haluci - A do të ketë aplikime të reja, apo jo ? Është anëtare e grupit zonja Drita. Do të ketë apo jo aplikantë të rinj.

Znj.Edlira Kapllanaj - Po nuk janë shpërnadrë ato të parat, janë 2 vjet e gjysëm. Prandaj, të miratohet sistemi i pikëzimit dhe pas këtyre do ngelen vende .

Znj.Elpinqi Mërkuri - Le ti japim kohë administratës. Mos ngatërroni popullatën . Të mbarojmë sistemin e pikëzimit.

Znj.Liljana Breshani – Ato shtëpi po shkatërrohen.

Z.Klodian Xhyheri – Në mënyrë të përmbledhur, në emër të grupit, të rritet pikëzimi, për grupin, vajzat-nëna, duhet rritur.

-komunitetit rom dhe egjyptian, mos ti ulen pikët

-hapja e aplikimeve të reja., mund të ketë të rinj që plotësojnë kushtet.

Z.Ervis Moçka – Që ka debate është shumë mirë. Është shumë sensitive çështja .

Dua të sqaroj,

1.Proçedura, shpallje...dosje, ka kaluar afati. Pra, mund ta kalonim në këshillin e mëparshëm , i cili mbikqyri punën e administratës, por nuk u pa sistemi i pikëzimit.

Ky sistem pikëzimi, ka 4 blloqe, ti i merrje në bllok. Administrata tani ka sjellë sistem shumë të detajuar, pra që të dalë shumë qartë. Ky sistem nuk kundërshtohet. Ky sistem pikëzimi, është “OK”. Këto kriterë të ardhura...,por të merret parasysh mendimi unanim i komisionit... ndryshimi në 25 pikë me 1 pikë... ishin 3 lëvizje. Pra ta kalojmë për miratim me propozimet e komisionit.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Pra, e kalojmë në votim me propozimet dhe ndryshimet e bëra nga komisioni përkatës i shërbimeve dhe te grupi me aftësi të kufizuara , të bëhet , me aftësi ndryshe. Votohet

Pro – 27 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 7 vota

Miratohet me ndryshimet e bëra.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 13/7, datë 30.10.2023

Z.Elpinqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 6 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për një saktësim në VKB Nr 32, datë 31.03.2023 “Për rinovimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës, të Shoqërisë K.F.Oriku “.

Z.Endri Hyseni – Është një projektvendim nga administrata, për një saktësim, është një vendim këshilli që ka kaluar në muajin mars 2023. Pra, vjen për saktësim, duke e bërë në 3 vjet nga 4, afatin e mandatit të këshillit mbikqyrës, të përbërë nga Agim Begotare dhe Arsen Belaj.

Znj.Elpinqi Mërkuri – Nëqoftëse, nuk ka gjë, e hedhim në votim.

Votohet.

Pro – 32 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota; 1 anëtar nuk morri pjesë në votim.

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 13/8, datë 30.10.2023

Znj. Elpiniqi Mërkuri – Kalojmë në pikën 7 të rendit të ditës, në miratimin e projektvendimit “Për miratimin e kërkesave, të cilat do të drejtohen administratës, për shpenzime të këshillit të bashkisë për vitin 2024”. Kryetari i komisionit juridik, ndryshimet e bëra në mbledhje.

Z.Endri Hyseni – U diskutua dhe në mbledhjen e komisionit juridik , u la me propozim të sekretarit të këshillit, buxheti i firmosur nga sekretari i këshillit, të ribëhej me firmën e kryetares së këshillit.

-Zëri i pagesës së kryepaqve të hiqen nga aktiviteti i këshillit, ti kalojë administratës.

-Të investohet më shumë në trainime, pra nga 200 mijë të bëhet 1 milion lekë. Ramë dakort.

Z.Klodian Xhyheri – Unë nuk shoh këtu , të jenë reflektuar mikrofonat. Është shtuar ?

Z.Daut Zëraj – Është konkluduar, është vendosur.

Z.Klodian Xhyheri – Pra, çdo gjë e ndryshuar..., duhet të na vijë varianti përfundimtar.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – Është dërguar materiali i ndryshuar.

Z.Gjergji Nika – Pak a shumë buxheti, u diskutua. Është shtuar zëri “24”..shërbime financiare , pra që këshilli të marrë një audit për të kontrolluar, mbikqyrur punën e administratës.

Znj.Elpiniqi Mërkuri – E kalojmë në votim.

Votohet.

Pro – 35 vota

Kundër – 0 vota

Abstenim – 0 vota

Miratohet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr _____ prot

Vlorë, më ____ . ____ 2023

Procesverbal
Nr 13/9 , datë 30.10.2023.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Viojmë me pikën “Të ndryshme “

Z.Gjergji Nika – Ne duhet të flasim të na dëgjojë administrata. Drejtorët më të rëndësishëm nuk janë. Mund të ngremë probleme të ndryshme.

Znj.Elpiniaqi Mërkuri – Ne gjithë shqetësimet tuaja, i kemi kaluar, por sa na janë përgjigjur.

Z.Daut Zëraj – Drejtorët që kishin projektvendimet në rendin e ditës, ishin për të mbrojtur materialet. Tani, duke qenë se, informacioni më emergjent është ai i zjarrëfikëses, dhe drejtori është i pranishëm.

Z.Erëmal Arapi – Administrata nuk është në gjendje të kthejë përgjigje.

Z.Myzafer Elezi – Fjala e zotit Elezi, (është bashkëlidhur) në lidhje me situatën e zjarreve dhe mbrojtjes kundër zjarrit.

Z.Grigor Dede – Unë nuk kam çtë shtoj, por të pohoj çka tha zoti Elezi për shërbimin zjarrfikës dhe policinë bashkiake.

-Siç e theksoi dhe zoti Gjergji apo zoti Moçka , për prezencën e drejtorëve të administratës tek, pika “Të ndryshme “. Po e ritheksoj që, për këtë pikë duhet të jenë prezentë.

-Një shqetësim për në zonën e rrugës “Transballkanike , rruga “Gjergj Kastrioti “ dhe “Dëshmorët” kalojnë shumë këmbësorë . Duhet administrata të reflektojë, ka shumë aksidente. Të bëhen kalimet e këmbësorëve me “kurrize”, është shqetësim ky edhe i zotit Xhyheri. Një zgjidhje sa më të shpejtë nga administrata.

Z.Gjergji Nika – Përsa i përket zjarrfikëses dhe policisë bashkiake , jam shumë dakort me diskutimin e zotit Elezi. Duhet të shihet buxheti për rritje të pagave. Për zjarrfikëset, janë 11 makina të prishura, shpenzimet për karburant, veshje, riparime të ndryshme .

Policia bashkiake, është fytyra e bashkisë. Në buxhet të shihet blerja e makinave, uniformave të tyre .

-Vlora ka qenë qyteti i palmave, por Vlora është mbushur me rrepa. Duhet një masë urgjente për krahasitjen e pemëve, kryesisht rrepave, që mbushen plot pluhur..

Z.Kastriot Begaj/ MZZH – Lidhur me shërbimin zjarrfikës, jemi munduar të zbatojmë ligjin, ndërhyrje mbrojtje të njeriut, të pronës etj.. Shërbimi zjarrfikës, kërkon një vëmendje të veçantë , si në pajisjen me automjete, uniformë, kushtet e punës, ndikojnë dhe ndryshimet klimaterike. Numri i stafit ende i pakompletuar. Janë 42 aktualisht.

-Shërbimi zjarrfikës ka nevojë për njerëz të trajnuar , ata që do të vijnë duhet të kalojnë shkollë trajnimi 3-6 muaj, jemi sektor.

-Niveli i pagave, nga pushteti qëndror të rishikohet . Vlora është shumë mbrapa në kompletimin e këtij shërbimi edhe me ambjente.

-Mungesa, duke marrë shkas nga zjarret që bien nëpër pallate , mungon autoshtetë, sepse ne duhet të ndërhyjmë në çdo rast fatkeqësie. Kostua e kësaj është shumë e lartë rreth, 400-500 mijë euro me buxhetin e bashkisë,kjo. Ju këshilltarë të bashkisë, ktheni vështrimin nga shërbimi zjarrfikës. Ju bëj thirrje, duam vëmendje .

Znj.Elpinqi Mërkuri - Faleminderit për të gjitha që thatë. Të gjitha fondet, nuk dimë sa janë shpenzuar . Dua të falënderoj shërbimin zjarrfikës të Himarës dhe Fierit, që erdhën në ndihmë të për shuarjen e zjarret në Risili dhe ,shpresoj të reflektohet në buxhetin e vitit të ardhshëm. Por dhe që nuk mund të realizohen të gjitha brenda 1 viti.

Z.Illir Aliaj – Shkaktëtarët kryesorë të këtyre zjarreve policia e shtetit të bëjë detyrën për ti kapur këta . Po të vësh re, zjarri vihet në disa parcela, janë sipërfaqe të ndryshme dhe me Ligjin 7501, janë lënë në mëshirë të fatit , dhe pastrimi .

Të mendohet nga administratorët e njësive të bëhet një lloj inventari .

-Në Rajonin Nr 1 , tek ish-Fabrika e Çimentos, është një urë. Ajo është e bllokuar, do vërshojnë ujrat deri tek shkolla “Ismail Qemali “, duhet të pastrohet.

-Duhet parë nga administrata dhe Kanali i Ujrave të Larta .., që mbaron mbi bashki. Shqetësim nga banorët, për pastrimin e kanalit.

Z.Geron Gunbardhi – Për të mos përsëritur , problemin e zjarrfikëses dhe policisë bashkiake..Për gjendjen e zjarrfikëses, bashkia mos ta shohë sot si prezente, se ka kaq kohë kjo gjendje.

Duhet falënderuar drejtori i ri i policisë bashkiake, ka ndryshime, por nuk bëhen të gjitha dot në të njëjtën kohë.

-Shumë toka në fshatin Risili, janë të bllokuara. Administrata të merret me hapjen e rrugëve, pra problem shumë zjarret dhe për bujqësinë.

-Administrata të merret, të mblidhet taksa e tokës bujqësore. Pse nuk mblidhet kjo taksë ? Të bëhet një inventar. Të gjendet, pse nuk është mbledhur kjo taksë, pastaj kalojmë tek buxheti.

Znj.Evis Allushi – Disa probleme në Rajonin Nr 3. Mbledhjen e kaluar ngrita 2 shqetësime. Më erdhi informacion nga drejtorja e shërbimeve. Janë 4 orare .Por shqetësimi im, nuk është vetëm tek banorët, por edhe tek turistët në lidhje me orarin e autobuzit tek zona e Kalasë, shqetësim që do ta sillja edhe një herë në vëmendje të administratës,ndërsa për Kopshtin Nr 10, nuk morra përgjigje. Po i bëj përsëri prezente këto 2 probleme. Pra, kur do fillojë rehabilitimi i kësaj zone ?

-Problem tjetër, 2 pallate mbas Sigurimeve Shoqërore, të niste procesi i fasadave të pallateve

-Depozitat e ujit mbi pallate , përveç pamjes, këto krijojnë probleme në soletën e pallateve. Pra, të gjendet një zgjidhje nga administrata, jo vetëm për estetikë .

Z.Grigor Dede – Edhe në këshillin e kaluar, pyetje të ndryshme për zjarrfikësen, unë i kam ngritur. Zjarrfikësja nuk është vetëm problemi ynë, por është problem kudo në Shqipëri. Gjërat nuk bëhen menjëherë.

Znj.Anxhela Shenaj – Tek pallati “Ili “Shpk, pjesa e pasme në Rajonin Nr 3, burim vatër infeksioni, mbushur me plehra. Është kthyer dhe në zhurmë, ndotje akustike, është shumë shqetësim nga banorët .

-Rrugica tek hotel “Martini “, parkohet, është me të drejtë dalje ose hyrje, të vihet sinjalistikë Është kthyer në kaos kjo rrugë. Ju lutem, merrni masa.

Z.Myzafer Elezi – Shqetësim nga banorët e lagjes “24 Maji “, janë 200 familje në Rajonin Nr 4, rruga “Gani Bejkosala”, rruga është shumë keq, gropa me ujë. Të merren masa. Të shikohet në buxhet , por kjo rrugë kërkon, kanalizime, asfaltime. Ne ngrejmë problemet dhe, kërkojmë realizimin e tyre, dhe më pas do kërkojmë komision për realizimin e tyre.

Pra, të jetë në projekt buxhetin e vitit 2024, rikonstruksionin e kësaj rruge.

Znj.Englantina Imeraj – Shqetësim i banorëve të Pallatit nr 1236 , rruga “Enver Jaho “, të ngrihet një komision, pasi nga materiali që kanë dërguar banorët..., të shihet, rrezikohet shembja e tarracës së pallatit .

-Banorët e Pallatit nr 1219, po të njëjtin shqetësim për boljerët. Një tjetër shqetësim në lidhje me shërbimin e transportit urban, ku të ketë akses falas për invalidët , pensionistët. Të bëhet një kontroll, të ngrihet një komision verifikues nga administrata.

Z.Elpinqi Mërkuri – Në lidhje me boljerët dhe unë e kam ngritur si shqetësim, për gjithë rajonet e Vlorës. Është shqetësim, di nga drejtori i shërbimeve që po bëhet një projekt në lidhje me këtë shqetësim, me investim, dhe kontribut dhe nga banorët , pra të gjitha rajonet.

Z.Klodian Xhyheri – Kam ngritur shqetësimin e banorëve tek ish-Fabrika e Tullave. Nuk ka ardhur.

Z.Daut Zëraj – Jemi në pritje.

Z.Klodian Xhyheri – Në lidhje me shërbimin e zjarrfikëses, duhet të kenë pajisjet e duhura, tu rriten pagat . Për mendimin tim, të ishte vënë në rendin e ditës dhe jo tek pika “ Të ndryshme” . Por, shumë shqetësues është zjarri në vendgrumbullimin e mbetjeve. Zjarret nuk mund të ndizen nga temperaturat e larta. Këtu vendosen zjarret me qëllim, mendoj unë. Ftoj prokurorinë, të bëjë hetimet për këtë çështje. Pas betimit të kryetarit të bashkisë që, nuk do ketë më zjarre, ka patur prapë zjarre. Kështu shprehen gjithë qytetarët.

-Shqetësim tjetër nga qytetarët, situata e infrastrukturës tek ish-Stacioni i trenit , pjesa e gjithë zonës. Problematika është situata infrastrukurore , tek ish-Stacioni Trenit. A ka ndonjë projekt për këtë zonë?

-Dy tecet lundruese..A është marrë leje nga ministria përkatëse ?Kjo veprimtari bëhet... Bashkia a ka ndonjë proces në lidhje me veprimtarinë e tyre, nëse ka ndotje? Ky projekt, nga shoqëria

mjedisore, ka ndotje të jashtëzakonshme. Vetëm një shoqëri ka ngritur zërin. Ne i bëjmë dëmtrim të madh mjedisit.

Znj. Alta Haluci – Në bazë të Rregullores, Neni 98..., kemi të drejtë të bëjmë kërkesë për interperlancë për kryetarin e bashkisë, për temat që diskutojmë.

Neni 146, faqja 100, përgjegjësitë e këshillit bashkiak ...Ne kemi disa pika si sheshi i Flamurit, sheshi Pavarësia, tecet lundruese, shërbimin urban etj... Cili është programi i Kryetarit të bashkisë, bazuar në Nenin 149, do rishikohet P.P.V, duhet të kemi një informacion pak më të thellë., duhet më shumë kohë për kryetarin e ri. Përgjigjet në varësi të kohës.

Z. Daut Zëraj - Për procedurë, kërkohet një interperlancë dhe e ngre këtu, dhe po e bëre me shkrim, rakordoni me njëri – tjetrin, zoti Klodian mos të trajtohet i njëjti problem, që trajton zonja Alta.

Për interperlancë, kryetarin, kërkesë të shkruar.

Znj. Rajmonda Zoto – Falënderoj Bashkinë Vlorë, për rehabilitimin e rrugës së spitalit.

-Shqetësim nga banorët e Rajonit Nr 5, për rehabilitimin e trotuarëve nga Gjyqi i vjetër – shkolla “Halim Xhelo”.

-A ka ndonjë informacion, pse qytetarët në këtë segment rrugor kanë më pak ujë dhe me orar?

-VKB Nr 95/2022, është vënë një tarifë...Pse kjo tarifë mbledhet pa u bërë shërbimi.

Z. Daut Zëraj – Kjo tarifë ska lidhje, nuk hyn tek kjo tarifë, është me atë çka mbetje nxjerr. Kompani private s’ka.

Znj. Rajmonda Zoto – Ne e kemi pastruar vetë, na ka ardhur në fund të vitit, tek ambulanca e lagjes sonë.

Znj. Elpiniqi Mërkuri – Në dijeninë time, është një projekt rehabilitimi për atë zonë, tek ish gjyqi. Punë të mira do të bëhen.

Z. Arsen Belaj - Bëjmë kërkesa, ankesa, përcjellim shqetësimet e qytetarëve. Ne flasim, shënohen, s’po marrim përgjigje. Të jenë më të përgjegjshëm. Të vëmë në punë administratën, të gjithë bëjmë ankesa. Do ishte më korrekte që drejtorët dhe administratorët të japin përgjigje. Të jenë më të përgjegjshëm.

Znj. Liljana Breshani – Mos prit çfarë do bëjë shteti, por çfarë po bën ti për shtetin, është një thënie. Por nuk shoh njeri të ndërmarrë një nismë. Po afrojnë festat e Nëntorit, asnjë se ngriti se si do zbukurohet, çfarë do bëhet për festat e Nëntorit.

Të ankoresh, është gjëja më e thjeshtë. Probleme patjetër që ka. Të mos i kërkojmë të gjitha nga bashkia, por të marrim nisma vullnetare.

Znj. Elpiniqi Mërkuri – Faleminderit për mbledhjen e sotme.

Mbajti Procesverbalin
Zhaneta Gjika